



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:277787  
Datë: 23.04.2024  
Numri i dokumentit: 05631283

**Ac.nr.8662/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi, dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.P.H., nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh.R.M., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës – Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti pagesa e pagave jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4071/19, të datës 25.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës – Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4071/19, i datës 25.10.2022, në piken I dhe II të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

**II.** Mbetet e pashqyrtuar pika III e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.4071/19, të datës 25.10.2022, ka vendosur si në vijim: “I .APROVOHET PJESËRISHT e bazuar kërkesëpadia e paditëses Sh.P.H., nga Prishtina. II. DETYROHET e paditura Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës – Qendra Klinike Universitare e Kosovës, që paditëses në emër të dy pagave jubilarë për dhjetë (20) vite të përvojës së punës të ia paguaj shumën prej 850.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë 26.11.2019 e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë

prej 124€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. III. REFUZOHET, pjesa e kërkesëpadisë me të cilën ka kërkuar pagesën e inflacionit në paga”.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të aprovoj në tërësi ankesën e të paditurës si të bazuar dhe padia e paditësit refuzohet si e pa bazë.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë e të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit, me datë 26.11.2019, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e pagës jubilarë dhe inflacionin në paga. Në padi, paditësja ka theksuar se është e punësuar tek e paditura SHSKUK – Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me kontratë pune në kohë të pacaktuar që nga data 09.08.1999 dhe me përvojë pune mbi 20 vite, ku kjo parashihet edhe me Marrëveshjen e Përgjithshme në nenin 52 par. 1 nen par.1.1, 1.2 dhe 1.3 si dhe të Kontratës Sektoriale. Sipas padisë, ka pretenduar se e paditura nuk ka bërë kompensimin e shpërblimit jubilar për përvojën e punës edhe pse me datë 11.06.2018 është nënshkruar Kontrata Kolektive Sektoriale në kohëzgjatje prej 3 vitesh. Paditëses shpërblimi jubilar i takon në bazë të marrëveshjeve të lartpërmendura. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë kërkesëpadinë dhe ta detyrojë të paditurën që t’ia kompensojë shumën prej 850.00 Euro në emër të dy pagave jubilarë si dhe inflacionin në paga, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë deri në pagesën definitive.

E paditura në përgjigje në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses për pagesën e shpërblimit jubilar, sepse me Ligjin e Punës Nr.03/L-212 nuk është paraparë kompensimi i shpërblimit jubilar. Sipas të paditurës, paditësja e ka mbështetur kërkesëpadinë në Kontratën Kolektive Sektoriale e cila është lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, andaj paditësja është dashur ta drejtojë padinë ndaj Ministrisë së Shëndetësisë. QKUK-së nuk i është ndarë buxhet për përmbushjen e këtij detyrimi dhe në mungesë të vijës buxhetore për këtë kategori QKUK nuk mund të bëjë përmbushjen e këtyre kërkesave edhe pse vazhdimisht QKUK ka kërkuar nga Qeveria që t’i ndahet buxhet për këtë kategori. Më tej ka theksuar se QKUK nuk është nënshkruese e marrëveshjes kolektive, andaj ka propozuar që padia e paditëses të refuzohet si e pabazë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të

paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.4071/19, të datës 25.10.2022, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar në mes të palëve ndërgjyqjese nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, si infermiere në Klinikën e Kirurgjisë, sipas kontratës së punës të datës 14.01.2013, ndërsa nga lista e pagave për paditësen, vërtetohet fakti se paditësja tani ka mbi 20 vite të përvojës së punës (në vitin 2022 ka mbi 22 vite përvojë) dhe ka pagën bazë prej 425.00 Euro. Nuk ishte kontestues fakti se paditëses nuk i është paguar shpërblimi jubilar në vlerë të 2 (dy) pagave bazë, siç përcaktohet me nenin 17 par. 3 pika 3.1 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKSSH) e cila ka paraparë se *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë [...] Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy pagave mujore të tij”*. Gjykata vlerësoi se në rastin konkret, Kontrata Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS) është e aplikueshme, pasi që e njëjta ka hyrë në fuqi me 11.06.2018 dhe është e zbatueshme për tre vite nga lidhja e saj. Në nenin 17 par. 4 të KKS parashihet se Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.

Nga gjendja faktike e vërtetuar gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se sipas ekstraktit të listës së pagave, paditësja në vitin 2020 ka pasur 20 vite të përvojës së punës, çka nënkupton se paditësja në kohën e hyrjes në fuqi të kontratës sektoriale i ka pasur të përmbushura kushtet ligjore për ti kërkuar dy paga jubilarë. Ndërkaq, paditësja padinë e ka parashtruar në kohën sa kontrata kolektive sektoriale ka qenë në fuqi dhe rrjedhimisht kërkesa e saj gjen mbështetje në këtë bazë juridike. Për vendosjen jashtë seancës gjyqësore, gjykata është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritot, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Andaj, bazuar në dispozitat e Nenit 398 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që ka vlerësuar se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses ishte pjesërisht e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës. Ndërsa për refuzimin e kërkesëpadisë për çështjen e inflacionit, gjykata e ka refuzuar pasi çështja e inflacionit nuk parashihet me Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, gjykata ka vlerësuar se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot. Lidhur me pretendimin se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, gjykata sqaron se Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, kanë marrë përsipër detyrimet që për stafin shëndetësor të garantojnë të drejta nga Kontrata Kolektive, përtej

standardeve minimale të garantuara me Ligjin e Punës. Rrjedhimisht, paditësja si kategori e punonjëses në sistemin shëndetësor i gëzon të drejtat dhe beneficionet e garantuara me Kontratën Kolektive, për të cilën e paditura në cilësi të punëdhënësit obligohet me detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë. Vendimin për kamatën e ka bazuar në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, gjeti së e paditura me ankesë aktgjykimin e atakuar e ka goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, mirëpo nga përmbajtja e ankesës rezulton së e paditura nuk e ka përmendur asnjë shkak se në çka konsistojnë këto shkelje, andaj meqenëse nuk ka gjetur se ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat Gjykata e Apelit, kujdeset sipas detyrës zyrtare, për këtë arsye kolegji nuk është lëshuar tutje lidhur me këtë bazë ankimore. Gjykata e Apelit e mbështet përfundimin dhe qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë së në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, në mënyrë që gjykata të vendosë jashtë seancës, pasi që ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk kanë ekzistuar pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor.

Sa i parket pretendimit për konstatim të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit, gjeti së e paditura këtë pretendim e bazon në faktin së gjykata e shkallës së parë nuk ka e ka marrë parasysh faktin se Kontrata Kolektive Sektoriale është e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatave të Shëndetësisë, dhe sipas të paditurës paditësja është dashur që Ministrinë e Shëndetësisë ta obligoj në përmbushjen e këtij detyrimi pasi që ajo është nënshkruese e kontratës dhe se në bazë të Ligjit të Punës neni 90 paragrafi 5 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punonjës të tyre të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje kolektive që do të thotë se QKUK nuk është nënshkrues i marrëveshjes në të cilën bazohet padia e paditëses. Sipas të paditurës Qeveria e Kosovës nuk ka ndarë buxhet për implementimin e kësaj kontrate e për këtë arsye e paditura nuk ka mundur dhe nuk mund të bëjë përmbushjen e këtyre kërkesave.

Gjykata e Apelit gjatë vlerësimit të këtyre pretendimeve ankimore gjen se të njëjtat janë të pabazuara për arsye se mos nënshkrimi i drejtpërdrejtë i Kontratës Kolektive Sektoriale nga ana e të paditurës nuk do të thotë se e paditura nuk ka obligim që të bëjë kompensimin e pagave jubilarë, pasi që Kontrata Kolektive Sektoriale është nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e autoritetit me të latë mbikëqyrës në sektorin e shëndetësisë, ku sipas nenit 4 të kësaj kontrate është përcaktuar së kjo kontratë gjëne zbatim për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivelet e sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tërësor, ndërsa sipas paragrafit 4 të nenit 17 të kësaj kontrate punëdhënësi i fundit është ai

që paguan shpërblime jubilarë, e që në këtë rast si punëdhënës është e paditura. Ndërsa lidhur me pretendimin se Qeveria e Kosovës nuk ka ndarë buxhet për të paditurën, Gjykata e Apelit vlerëson së koordinimi në mes të nivelit qendror dhe lokal në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave që buron nga Kontrata Kolektive është çështje e brendshme e të paditurës me nivelin qendror dhe kjo assesi nuk mund të afekton në të drejtën e paditëses dhe detyrimin e të paditurës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që në bazë të nenit 17 par.3, pika 3.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 11.06.2018, është paraparë së *“Punëtorët shëndetësor në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy pagave mujore të tij”*. Tutje sipas paragrafit 4 të këtij neni përcaktohet së *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*. Në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura ku në bazë të vërtetimit për përvojën e punës të datës 23.10.2019, të lëshuar nga e paditura, është vërtetuar fakti së paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura që nga data 09.08.1999, e që rezulton së 20 vite të përvojës së punës i ka arritur me datë 19.08.2019, në kohën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale e datës 11.06.2018. Andaj, gjykata e shkallës së parë duke i referuar këtyre dispozitave, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur që paditëses për 20 vite të përvojës së punës t’i njihet kompensimi në vlerë të dy pagave mujore, ku sipas vërtetimit dhe listës së pagave është vërtetuar së paga mujore e paditëses është 425.00 euro.

Vendimi lidhur me kumatën është marrë konform nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimit juridik për kumatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 02.12.2020. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449, 452.1, dhe 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar aktgjykimin e atakuar në pikën III të dispozitivit, pasi që nuk kishte pretendime ankimore sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadsisë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8662/2022, datë 23.04.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari

Hysni Bardheci